



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1494 prot.

Elbasan, me 14.07.2021

VENDIM

Nr. 31 datë 14.07.2021

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VBA NR 12 DATË 06.03.2021 "PËR
ULJE TARIFE VJETORE E SHKOLLIMIT TË STUDENTËVE NË CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE, PËR PROGRAM TË PARË STUDIMI, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 780, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", VBA nr 49 datë 20.11.2020 "Për procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të uljes së tarifës vjetore të shkollimit të studentëve të Ciklit të dytë të studimeve, për program të parë studimi për vitin akademik 2020-2021", Relacionit të Administratorit "Për një ndryshim në VBA nr 12 datë 06.03.2021 'Për ulje tarife vjetore e shkollimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2020-2021'", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- 1- znj. Argesta Stërgu të përjashtohet nga kosto e plotë e studimeve për Ciklin e dytë të studimit në Master i shkencave "Matematikë e zbatuar" në FSHN, si studente e shkëlqyer.
- 2- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI**

